

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik në pajtim me Nenin 87, paragrafin 2, nën paragrafin 2.9 dhe nenin 91 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, nxjerrë këtë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr. 02/2014

Për Sigurinë e Tenderit, Sigurimin e Ekzekutimit dhe Aplikimin e kriterit përzgjedhës ekonomik dhe financiar.

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është që të ofrojë sqarime për Autoritetet Kontraktuese në zbatimin e Nenit 57 (Sigurimi i Tenderit) dhe 63 (Siguria e Ekzekutimit) të Ligjit mbi Prokurimin Publik Nr 04/L-042. Për më tepër, për t'ju ofruar Autoriteteve Kontraktuese sqarime në aplikimin e kriterit përzgjedhës, me theks të veçantë të Nenit 68 (Gjendja ekonomike dhe financiare) e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik.

Neni 2

Termat e përdoruar

Termat e përdorur në këtë Udhëzim Administrativ kanë të njëjtin kuptim siç përmenden në Nenin 4 (Përkufizimet) të Ligjit Nr 04/L-042 për Prokurimin Publik.

Neni 3

Formulari i Sigurimit të Tenderit

1. Sipas dispozitave të përbashkëta në fuqi nenit 57, paragrafi 5 të LPP, dhe nenit 26, paragrafi 5 të Udhëzuesit për Prokurimin Publik të miratuar nga KRPP-ja, sigurimet e tenderit mund të ofrohen nga tenderuesit sipas gjykimit të tyre të vetëm, ekskluzivisht në njërin nga format e mëposhtme:
 - o në para të gatshme ose të barasvlershëm, siç është transferi bankarë;
 - o çek i certifikuar nga një bankë me reputacion;
 - o letër krediti të pakushtëzuar të hapur dhe të konfirmuar nga një bankë me reputacion;
 - o bono të përformancës, të zbatueshme me kërkesë, të lëshuar nga një kompani e sigurimeve me reputacion
 - o garanci Bankare të pakushtëzuar të lëshuar nga një bankë me reputacion.
2. Për qëllimet e paragrafit paraprak:
 - (i) **një bankë "me reputacion"** nënkupton një bankë që ka klasifikim afat-gjatë të paktën "A" sipas një ose më shumë agjencive të vlerësimit ose në rast të një banke në Kosovë (nëse banka nuk është e vlerësuar në atë formë) një bankë që është e licencuar nga Autoriteti Qendror Bankarë në Kosovë.
 - (ii) **një kompani e sigurimeve "me reputacion"** nënkupton një kompani të sigurimeve që ka klasifikim afat-gjatë të paktën "A" sipas një ose më shumë agjencive të vlerësimit ose në rast të një kompanie të sigurimeve në Kosovë

(nëse kompania e sigurimeve nuk është e vlerësuar në atë formë) një kompani të sigurimeve që është e licencuar nga Autoriteti Qendror Bankarë në Kosovë.

3. Në pajtim me paragrafin 2, autoritetet kontraktuese nuk do të kufizojnë në dokumentet e tenderit diskrecionin e tenderuesve që të paraqesin sigurimin e tenderit në cilëndo nga format e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni. Çdo dispozitë që kufizon formën në të cilën sigurimet e tilla mund të dorëzohen përveç atyre të referuara në paragrafin 1, do të konsiderohet e pavlefshme.

Neni 4

Formulari i Sigurimit të Ekzekutimit

1. Sipas dispozitave të përbashkëta në fuqi nenit 63, paragrafi 5 të LPP dhe nenit 27, paragrafi 5 të Udhëzuesit për Prokurimin Publik të miratuar nga KRPP-ja, sigurimet e ekzekutimit mund të lëshohen nga operatori ekonomik i cili është shpërblyer me kontratë, sipas gjykimit të tij të vetëm, ekskluzivisht në njërin nga format e mëposhtme:
 - o në para të gatshme ose të barasvlershëm, siç është transferi bankarë;
 - o çek i certifikuar nga një bankë me reputacion;
 - o letër krediti të pakushtëzuar të hapur dhe të konfirmuar nga një bankë me reputacion;
 - o bono të performancës, të zbatueshme me kërkesë, të lëshuar nga një kompani e sigurimeve me reputacion;
 - o garanci Bankare të pakushtëzuar të lëshuar nga një bankë me reputacion.
2. Për qëllimet e paragrafit paraprak një "bankë me reputacion" dhe një "kompani e sigurimeve me reputacion" kanë të njëjtin kuptim me atë të dhënë në nenin 3, paragrafi 2.
3. Në pajtim me paragrafin 2, autoritetet kontraktuese nuk do të kufizojnë në dokumentet e tenderit diskrecionin e operatoreve ekonomik që të paraqesin sigurimet e ekzekutimit në cilëndo nga format e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni. Çdo dispozitë që kufizon formën në të cilën sigurimet e tilla mund të dorëzohen përveç atyre të referuara në paragrafin 1, do të konsiderohet e pavlefshme.

Neni 5

Gjendja ekonomike dhe financiare

1. Sipas nenit 68 të LPP, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga tenderuesit plotësimin e kërkesave minimale ekonomike dhe financiare si kriter për përzgjedhje për pjesëmarrje në një procedurë tenderuese. Qëllimi i këtij kriteri është që të vlerësojë nëse tenderuesi ka stabilitet të mjaftueshëm ekonomik dhe financiar për të performuar kontratën e propozuar.

Kërkesat e tilla minimale nuk i referohen detyrimit:

- qarkullimet globale, duke përfshirë këtu një qarkullim minimal eventual në një fushë specifike në kuadër të kontratës;
 - llogaritë vjetore, duke përfshirë informacione në lidhje me asetet dhe detyrimet aktuale;
 - burimet financiare në dispozicion;
2. Autoritetet kontraktuese do të kufizojnë kërkesat duke lënë vetëm ato që janë të përshtatshme për të siguruar që tenderuesi ka sigurinë e nevojshme ekonomike dhe financiare për të përformuar kontratën e dhënë. Të gjitha kërkesat do të jenë strikt të lidhura dhe proporcionale me temën e kontratës në mënyrë që të sigurojnë një garë të drejtë dhe të sqartë.
3. Në përcaktimin e qarkullimit minimal, autoritetet kontraktuese nuk duhet të kalojnë dy herë vlerën e parashikuar të kontratës, përveç në raste të justifikuara siç bëjnë ndaj rreziqeve të veçanta që lidhen me natyrën e punëve, shërbimeve ose furnizimeve të ofruara. Autoriteti kontraktues do t'i specifikojë rrethanat e tilla të jashtëzakonshme në dokumentet e tenderit. Kërkesat për qarkullim duhet të shprehen detyrimisht në shifra dhe do t'i referohen maksimum tri viteve të fundit financiare të përfunduara nga data e publikimit të njoftimit të kontratës. Vitet e tilla financiare do të tregohen shprehimisht në Njoftimin e Kontratës ose në Ftesën për Tender ose Pjesëmarrje.
4. Kur, përveç qarkullimit minimal, një qarkullim i caktuar minimal në fushat specifike të mbuluara nga kontrata është i nevojshëm, qarkullimi i tillë nuk duhet të tejkalojë 1.50 herë vlerën e parashikuar të kontratës. Të gjitha dispozitat tjera të referuara në paragrafin 3 dhe 5 të këtij neni zbatohen edhe në këtë rast.
5. Përsa i përket paragrafit 3 dhe 4 të këtij neni, autoritetet kontraktuese do të shprehin në Njoftimin e Kontratës kushtin për kualifikim, duke përzgjedhur në mesin e njërit prej kritereve vijuese:
- 1) xhiroja **totale** e tenderuesit në tri vitet e fundit financiare duhet të kalojë (ose të jetë i barabartë) me qarkullimin minimal siç tregohet në Njoftimin e Kontratës.
 - 2) Qarkullimi **mesatar** i tenderuesit në tri vitet e fundit financiare duhet të tejkalojë (ose të jetë e barabartë), për secilin prej këtyre viteve financiare, kërkesës minimale për qarkullim siç tregohet në Njoftimin e Kontratës
 - 3) vetëm kur kontrata ka një kohëzgjatje më të gjatë se një vit, qarkullimi mesatar i tenderuesit gjatë tri viteve të kaluara financiare duhet të kalojë (ose të jetë e barabartë), për secilin prej këtyre viteve financiare, kërkesa minimale vjetore për qarkullim përcaktohet sipas formulave të mëposhtme matematikore: $Vlera\ e\ kontratës / numri\ i\ viteve \times 2$ ose $vlerës\ së\ kontratës / numri\ i\ muajve \times 12 \times 2$.

Në rast të dorëzimit të tenderit nga një grup, formulat e mësipërme për përshtatshmëri do të aplikohet edhe te grupi si një njësi.

6. Pavarësisht nga paragrafi 2 i këtij neni, autoritetet kontraktuese do të specifikojnë në Njoftimin e Kontratës se cilin nga kriteret që përmenden në paragrafin e mësipërm do të aplikojnë. Zgjedhja do të bëhet nën diskrecion të autoriteteve kontraktuese në mënyrë jo-diskriminuese, dhe në çdo rast duke marrë parasysh qëllimin e kontratës, rreziqet në lidhje me zbatimin e kontratës dhe vetë kushtet specifike të tregut specifik në mënyrë që të mos e kufizojë konkurrencën.
7. Kur kontrata është e ndarë në lote, neni aktual do të zbatohet në secilin lot individualisht. Megjithatë, autoritetet kontraktuese mund të vendosin xhiro minimale që tenderuesit duhet të kenë duke iu referuar grupeve në lote në rast se ofertuesit të suksesshëm i janë dhënë disa lote për tu kryer në të njëjtën kohë.
8. Kur kontratat e bazuara në kontratë kornizë duhet të jepen sipas procedurës për rihapje të konkurrencës, kërkesat maksimale për qarkullim do të llogariten mbi bazën e vlerës së pritshme maksimale të kontratave të veçanta që do të jepen, ose, ku kjo nuk dihet, në bazë të vlerës së parashikuar të marrëveshjes kornizë.
9. Sipas nenit 68 paragrafi 2 të LPP-së, autoritetet kontraktuese do të specifikojnë kërkesat minimale ekonomike dhe financiare në Njoftimin për Kontratë ose në Ftesën për Tender ose Pjesëmarrje. Për më tepër autoritetet kontraktuese do të specifikojnë qartë në dokumentet e lartpërmendura, për çdo kërkesë ekonomike dhe financiare, referencat e përshtatshme në mesin e atyre të parashikuara në nenin 68, paragrafi 1, nënparagrafët 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të LPP-së.
10. Deklaratat e nevojshme sipas nenit 68, paragrafi 1, alineja 1.1, e LPP-së do të lëshohen nga bankat e klasit të parë.
11. Polica e sigurimit, sipas nenit 68, paragrafi 1, alineja 1.2, e LPP-së, do të lëshohet nga një kompani e njohur e licencuar e sigurimeve.
12. Për qëllimet e paragrafit paraprak një "një bankë e klasit të parë" dhe një "kompani e njohur e licencuar e sigurimeve" kanë të njëjtin kuptim të dhënë në nenin 3, paragrafi 2.

Neni 6

KRPP-ja është duke përgatitur një Udhëzues në mënyrë që të sqarojë më tej me shembuj aplikimin e rregullave që i referohen Neni 4 të Udhëzimit Administrativ aktual.

Neni 7

Hyrja ne fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hynë në fuqi më 08 janar 2014

08 01 2014
(Data e nënshkrimit)



Safet Hoxha- Kryetar i KRPP-së